




PRISHTINA

**NARRATIVA E
PRISHTINËS
MATERIAL PËR
PËRDORIM**

A low-angle photograph of a brick clock tower. The tower is constructed from reddish-brown bricks and features two large, circular black clock faces with white Roman numerals and hands. The tower has a square top section with arched windows and a small flag flying from a pole on the roof. The sky is a clear, bright blue. The text 'Sahatkulla është ndërtuar në shekullin XIX.' is overlaid in the bottom left corner.

**Sahatkulla
është ndërtuar
në shekullin
XIX.**

NARRATIVA E PRISHTINËS

Historik konciz i Prishtinës



**Pristina i ka
rreth 460 mijë
banorë në nivel
të qarkut.**



KIRAÇ

MİTOSKA
MİTOSKA
Pul
Pul
Aerodrom
Aerodrom

MİTOSKA
MİTOSKA
Pul
Pul
Aerodrom
Aerodrom

MİTOSKA
MİTOSKA
Pul
Pul
Aerodrom
Aerodrom

MİTOSKA

Historia e hershme dhe etimologjia

Shekulli 14 deri 17

Shekulli 18 dhe 19

Fillimi i shekullit 20

Vitet e 60-ta

Vitet e 70-ta dhe 80-ta

Vitet e 90-ta

Pas vitit 1999

Prishtina sot

Dromca të informatave

Përmbajtja



PRISHTINA

Ky publikim është përpiluar me qëllim të përmbledhjes së informatave kryesore që lidhen me historinë e qytetit të Prishtinës. Materialet janë mbledhur nga një ekip punues i emëruar nga Komuna e Prishtinës në vitin 2018 dhe janë organizuar kronologjikisht. Një pjesë e të dhënave më karakteristike janë veçuar si dromca të informatave në fund. Narrativa është bazë për përdorim në materialet informuese të Komunsë së Prishtinës, në fushat e turizmit, kulturës dhe të tjera. Fotografitë në këtë publikim janë me të drejta të hapura dhe mund të përdoren dhe replikohen nga çdokush. Të gjitha materialet e këtij dokumenti janë të hapura për të gjithë për kopjim, ripërdorim dhe publikim.

Historik i shkurtë i Prishtinës

Historia e hershme dhe etimologjia

Rrethina e Prishtinës, si hapësirë në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik ka gjurmë të banimit qysh nga koha e neolitit. Në afërsi të Prishtinës ndodhet edhe qyteti antik i Ulpianës, i cili është themeluar në shekullin II dhe ka qenë i banuar deri në vitin 518, kur është braktisur pas një tërmeti shkatërrues. Në afërsi të Prishtinës ndodhet edhe vendbanimi i Graçanicës, ku gjendet kisha ortodokse e themeluar në vitin 1321, në rrënojat e një kishe të shekullit VI. Në themelet e kësaj kishe mund të shihen edhe pllaka të mermerit me mbishkrime latine. Nuk ka një konsensus të gjuhëtarëve rreth etimologjisë së Prishtinë, megjithëse janë publikuar disa hipoteza.

Shekulli 14 deri 17

Dokumenti i parë historik, i cili e përmend Prishtinën sipas emrit, i përket vitit 1342, kur Perandori Bizantin, Jan VI Kantakouzenos, e përshkruan Prishtinën si “fshat i rrethuar pa mure”. Në mesjetë, qyteti kishte qenë pjesë e sundimeve dhe e principatave të ndryshme bizantine dhe serbe, përfshirë ato të Stefan Milutinit, Stefan Uroshit III, Stefan Dushanit, Stefan Uroshit V dhe Vuk Brankoviqit. Prishtina bie nën pushtimin osman qysh nga Beteja e Kosovës në vitin 1389, betejë e zhvilluar në Fushë Kosovë, rreth 5 kilometra larg qendrës së qytetit.

Beteja e Kosovës shënon fundin e sundimit serb në Kosovë dhe, në përgjithësi, rënien e periudhës bizantine në këto treva. Koalicioni

ballkanik, i përbërë nga serbë, bullgarë, boshnjakë, shqiptarë dhe rumunë humb betejën kundër ushtrisë osmane. Kosova - dhe gjithë Ballkani - bie nën sundimin e gjatë osman deri në vitin 1912. Prishtina, gjatë shekujve XIV dhe XV përjeton një prosperitet ekonomik. Pozita e saj në afërsi të minierave të Novobërdës dhe të Stantërgut bënte që Prishtina të zhvillohej si një qendër e rëndësishme tregtare dhe artizanale. Shënimet tregojnë se kishte edhe një koloni raguziane në qytet. Të dhënat e para që dalin në vitin 1477, në Defterin osman, e përshkruajnë Prishtinën si vendbanim me 9 lagje dhe 351 shtëpi. Në Defterin e vitit 1570, të përfshirë në Nahijen e Moravës të Sanxhakut të Vuçitërnës, Prishtina përshkruhet si Kasaba osmane me 11 lagje myslimane dhe 9 të krishtera.

Ndërtesa më e vjetër në Prishtinë, është Xhamia e Gurit dedikuar Sulltan Bajazitit I, e cila ka filluar së ndërtuari në fund të shekullit XIV, kur ende qyteti sundohej nga familja vasale Brankoviq. Ajo mbase është Xhamia me e vjetër në Ballkan e mbijetuar deri sot. Menjëherë pas Betejës së Kosovës më 1389, Jilldirim Bajaziti në emër të fitores triumfale të ushtrisë turke e vuri gurthemelin e kësaj xhamie, ndërsa punimet përfundimtare i ndërmori Sulltan Mehmeti II Fatihu. Qytetarët i referoheshin kësaj xhamie edhe me emra të tjerë si 'Sagër Xhamie', 'Muradija Xhamia', 'Çarshi Xhamia' dhe 'Tash Xhamia'. Prishtina si qytet gjatë periudhës osmane njihet edhe për tregun e rëndësishëm në qendër të qytetit, i cili ka shërbyer për banorët, por

edhe për vizitorët që kalonin aty pari, duke shërbyer si lidhje e mirë mes tregtarëve endës dhe atyre nga jashtë. Me gjithë numrin e madh të banorëve, në përjashtim të ndërtesave publike, shumica e ndërtesave të banimit janë ndërtuar nga dheu dhe në një ose dy kate. Një pjesë e tyre mund të shihen edhe sot në qendrën e vjetër të qytetit.

Periodha osmane njeh zhvillimin e qytetit përmes ndërtimeve të ndryshme kryesisht fetare, por edhe të tjera publike. Në këtë periudhë janë ndërtuar hamame, xhami, çeshme, rrugë, hane dhe pazare.

Më 1461, është e ndërtuar "Xhamia e Mbretit", e cila i dedikohet Sulltan Mehmet Fatihut. Ajo është ndërtuar sipas urdhrit të Sulltan Mehmet Fatihut II - Pushtuesit, i cili njihet për pushtimin e Stambollit nga Bizantinët. Gjatë luftërave austro-turke në fund të shekullit XVII, kjo xhami është shndërruar në kishë katolike jezuite. Këtu ka qenë i varrosur Pjetër Bogdani, njëri ndër personalitetet më të shquara shqiptare të periudhës. Me një forcë prej rreth 6.000 pjesëtarësh, Pjetër Bogdani i mbështetur edhe nga forca austro-hungareze, e kishte çliruar qytetin nga osmanët në fundshekullin XVII. Bogdani kishte vdekur si pasojë e mortajës që kishte lënë të shkatërruar një pjesë të madhe të qytetit. Pas humbjes së luftës së austriakëve në vitin 1690 eshtrat e Bogdanit zhvarrosen dhe hidhen në rrugë nga ushtria turke, kurse ndërtesës i kthehet funksioni i mëparshëm.

Udhëpërshkruesi i famshëm turk, Evlia Çelebiu, viziton Prishtinën me 1660, duke



e përshkruar si vendbanim me 2060 shtëpi, të gjitha me oborre të mëdha, me kopshte e vreshta; me 12 faltore prej të cilave 6 xhami për t'u falur; me pazar, medrese, shkollë dhe teqe të dervishëve; me shatërvanë dhe ujë shërues; me 11 hane. Në Pazar, sipas tij, gjendet Hamami i Sulltan Mehmetit Pushtuesit që është bërë vend pelegrinazhi, për shkak të fuqisë shëruese. Prishtina kishte 300 dyqane që konsideroheshin pak për një qytet me këto përmasa. Ndërkaq njerëzit, thotë Çelebiu, ishin bujarë dhe mikpritës, duke ofruar çdo natë gosti për mysafirët.

Ndër fotografitë e para të qytetit në fillim të shekullit 20.

Shekulli 18 dhe 19

Duke shërbyer edhe si qendër e tregtisë, në Prishtinë, për një periudhë gjatë shekujve XVIII – XIX është mbajtur edhe panairi ndërkombëtar i mallërave, ku tregtarë nga vende të ndryshme të botës kanë qenë vizitorë dhe kanë tregtuar. Ndërkohë, në shekullin XIX, në shtëpinë e Emin Gjikut, hapet edhe muzeu i parë, ku ekspozohen ekspozonate private të familjes.

Në vitet e fundit të pushtimi osman, Prishtina e kishte humbur rëndësinë e saj si qytet, mirëpo kishte rëndësi ushtarake. Diplomati dhe albanologu austro-hungarez, Johann Georg von Hahn, i cili e kishte vizituar Prishtinën më 1858, e përshkruan atë si qendrën më të madhe ushtarake pas Manastirit, me plot ushtarë që mbanin armë. Gjatë shekullit XIX, Jashar Pasha, udhëheqës lokal, kishte ndërtuar një xhami që sot njihet si Xhamia e Jashar Pashës. Gjithashtu, është ndërtuar Sahatkulla, me lartësi 26 metra. Prej vitit 1883 deri në vitin 1897, Prishtina bëhet kryeqyteti i Vilajetit të Kosovës. Në këtë kohë, ashtu si në të gjithë perandorinë vërehen edhe ndikimet e para të arkitekturës evropiane. Kazerma (sot Muzeu i Kosovës), e ndërtuar më 1884, i sjell frymë të re arkitekturës së qytetit. Ndërtesa është ngritur sipas projektit të punuar në Zyrën Ushtarake në Graz, si ndërtesë për stafin e garnizonit osman.

Përderisa arkitektura tradicionale për objektet rezidenciale të qytetit përbëheshin kryesisht nga ndërtesa dykatëshe me tulla prej dheut, në shekullin XIX fillojnë ndërtesat e reja më të larta, me tulla më të forta dhe me lartësi më të madhe. Ndër shembujt më të mirë të kësaj arkitekture është edhe shtëpia që ka shërbyer si shkolla e parë shqipe në vitin 1908, e ndërtuar pak para vitit 1880. Ndërtesë tjetër me influencë evropiane në arkitekturë është edhe ish-konsullata, e ndërtuar po ashtu në fund të shekullit XIX.

Prishtina, në vitin 1874, e kishte ndërtuar

edhe stacionin e parë të trenit, objekt i ndër-tuar nga britanikët. Sipas disa shënimeve, treni që lidhte Selanikun me Mitrovicën nuk është pranuar fillimisht mirë nga banorët lokalë, duke e sulmuar shpesh. Por më pas, me ardhjen e mallrave dhe të mundësive të reja për tregti, qytetarët e Prishtinës kanë kërkuar që të shtohen stacionet dhe të bëhen linja të reja.

Shekulli 20 dhe 21

Në vitin 1912, Prishtina çlirohet nga pushtimi osman përmes forcave të udhëhequra nga Hasan Prishtina. Në po të njëjtin vit, ajo pushtohet nga forcat serbe. Në vitin 1915 ajo shkurtimisht vendoset edhe nën okupimin bullgar, deri në vitin 1918, kur forcat franceze e kthejnë në okupim të Mbretërisë Jugosllave. Kjo periudhë ndiqet me program intensiv të kolonizimit serb që përcillet edhe me tjetërsim të pronave të popullatës shqiptare. Këto politika kanë sjellë valë dyndjesh të shqiptarëve nga Prishtina, duke e krijuar një mërgatë shqiptare në Turqi që vazhdon ende të jetë aty.

Në vitin 1941, Italia e përfshin Prishtinën si pjesë të okupimeve në kuadër të fushatës së saj ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore (LDB). Gjatë kësaj periudhe, Prishtina bëhet pjesë e Shqipërisë së pushtuar nga Italia. E më pas, për një kohë të shkurtër deri në çlirim, edhe nga Gjermania.

Në prag të mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës u organizuan në mënyrë ushtarake dhe politike. Në fund

të vitit 1943 dhe fillim të vitit 1944, u thirr Konferenca e Bujanit, ku njëra ndër pikat e dakorduara ishte edhe e drejta e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje. Pavarësisht vullnetit nga pala e shqiptarëve komunistë, Kosova ngeli pjesë e Jugosllavisë. Kosova me Kushtetutën e parë të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, miratuar më 31 janar 1946, u definua si njësi autonome territoriale – administrative brenda Serbisë e quajtur Qarku Autonom i Kosovës dhe i Metohisë. Me këtë kushtetutë, shqiptarët e Kosovës nuk u trajtuan si të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë.

Periodha pas LDB njihet me ndryshimet të mëdha demografike dhe urbanistike në qytet. Rikthimi i qytetit nën dominimin jugosllav rezulton me dinamika të reja në raport me qytetarët e Prishtinës. Kjo reflektohet veçanërisht te popullata shqiptare e qytetit. Situata e re e krijuar, me veprimet e ndërmarra veçanërisht nga Ministria e Punëve të Brendshme e Jugosllavisë e udhëhequr nga Aleksandar Ranković, ndër të tjera, nxiti edhe shpërngulje të re të shqiptarëve në Turqi përmes një marrëveshjeje ndërshtetërore midis Turqisë dhe Jugosllavisë.

Prishtina u shpall kryeqyteti i Kosovës më 1947. Me planin urban të qytetit të vitit 1953, ai u kthye në një qytet 'modern' prej 50.000 banorësh, mbi gërmadhat e qytetit të vjetër. Gjatë viteve të '50-a deri në vitet e '70-a, nën moton "shkatërro të vjetrën dhe ndërto të renë", u rrënuan pjesë të lagjeve të qytetit, përfshirë çarshinë e vjetër të qytetit, për t'u

ndërtuar ndërtesa banimi, administrative, shëndetësore, shkollore, sheshe e përmendore. Në emër të ndërtimit të qytetit të ri socialist, rrënohen shtëpi të shumta qytetare, hane e konakë. Mbi këto themele ndërtohet blloku i parë i ndërtesave moderne të banimit, në vitin 1948. Pastaj rrënohet Çarshia e Vjetër, mbi të cilën u ndërtuan ndërtesa e Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Kosovës dhe sheshi i Vllazërim-Bashkimit, sot sheshi Adem Jashari; rrënohet xhamia e Llokaqit së bashku me shtëpitë e kësaj lagjeje, ku më vonë u ndërtua hotel Iliria, sot hotel privat; rrënohet kisha e vogël katolike te sheshi Zahir Pajaziti; rrënohet sinagoga e vetme e qytetit që ndodhej brenda çarshisë; rrënohet hamami i çarshisë, i cili gjendej ku gjendet sot Parlamenti i Kosovës, ndërsa themelet e atij hamami janë të dukshme edhe sot.

Shumica e lagjeve të vjetra, së bashku me strukturën e vjetër të qytetit, kanë humbur. Ka mbetur vetëm një pjesë në qendrën e vjetër të qytetit me disa rrugica dhe rrugë. Fragmente të lagjeve të dikurshme sot janë disa nga monumentet: Shtëpi banimi – Luan Rudi (ndërtesa e Kodakut); Shtëpi banimi – Ismajl Sahatqiu (Shpija e vjetër); Shtëpi banimi – Musli Hoxha (shtëpia e avokatit - përballë OSCE-së); Shtëpi banimi – Mirnije Lleshi dhe disa nga shtëpitë qytetare qindravjeçare në lagjen Topnhane (ish – Divanjolli) dhe lagjen Vellusha. Gjurmë e xhamisë së Llokaqit është shatërvani i kësaj xhamie, i zbuluar gjatë shtrimit të bulevardit “Nënë Tereza” në vitet 2012-2013. Tani edhe shatërvani është aset

i mbrojtur nën emërtimin Çashmja në sheshin Ibrahim Rugova. Më 1988, Prishtinës iu mbuluan dhe betonuan lumenjtë Prishtevka dhe Vellusha.

Demonstratat e 1968

Fryma e ndryshimeve që po mbretëronin te gjithandej nëpër botë, në Prishtinë sjell demonstratat e para politike të organizuara në qytet—megjithëse ato ishin të përhapura gjithandej Kosovës. Për shkak të politikave që trajtonin popullatën shqiptare ndryshe nga popujt tjerë të Jugosllavisë, kishte kërkesa në rritje për vetëqeverisje dhe më shumë të drejta. Këto kërkesa u parashtruan edhe në tubime dhe debate të organizuara nga shqiptarët. Në nëntor 1968, shpërthyen demonstratat studentore me kërkesa për shkollim, universitet dhe të drejta të barabarta me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Pas tentimit për shtypje të demonstruesëve, protesta eskaloi me një protestues të vrarë, disa të plagosur dhe shumë të arrestuar.

Demonstrata, megjithatë, pati efekte themelore për ndryshimet kushtetuese të Jugosllavisë. Në vitin e ardhshëm filluan të miratoheshin amendamentet e para, të cilat vazhduan deri në vitin 1971 që pastaj do të çonin deri në miratimin e Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974. Çështja më me rëndësi për shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi ishte themelimi i Universitetit të Prishtinës më 1970. Gjuha shqipe u zyrtarizua me Kushtetutën e 1974-ës dhe institucionet në Kosovë e përdornin dygjuhësinë

- shqipe dhe serbe. Për shkak të mbylljes së kufirit mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, Prishtina ishte kryeqytet jozyrtar i shqiptarëve në Jugosllavi.

Shkurti i vitit 1974, shënon themelimin e autonomisë së Kosovës nën Serbi, me një status pothuajse të njëjtë si të Republikës, kurse Prishtina ishte kryeqytet. Po këtë vit, u hap edhe Pallati i Shtypit në Prishtinë, si forcim i gazetës ditore në gjuhën shqipe, "Rilindja", që do të ishte promotor i zhvillimit social dhe politik të shqiptarëve. U hoq nga përdorimi emri Metohi për Kosovën dhe u reduktua dallimi në numra mes shqiptarëve dhe serbëve në administratë, në pushtetin gjyqësor etj. Vitet '70-të, në Jugosllavi njihen si vite më progresive, ku Kosova po fillonte të shihte një progres sado të ngadalshëm, ekonomik dhe politik. Megjithatë, kjo periudhë ishte e shkurtër, meqë fillimi i viteve '80-të nxirrri në sipërfaqe tensionet e pabarazive ekonomike dhe politike.

Demonstratat e 1981

Me 11 mars të vitit 1981, në Prishtinë, më saktë në qendrën e studenteve, filloi një reaksion spontan nga studentët që po kundërshtonin për kushtet e rënda në konvikte. Ky reagim u shndërrua në demonstratë gjithëpopullore dhe me përgjigje të dhunës brutale nga policia.

Më 30 mars, në Prishtinë, studentët filluan bojkotimin e mësimi si vazhdimësi e reaksioneve dhe më 1 prill studentët filluan përsëri demonstratën duke marshuar



Muzeu Etnologjik në Prishtinë është ndër më të vizituarit nga turistët e huaj dhe shqiptar.



rrugëve kryesore të Prishtinës. Reagime të njëpasnjëshme me pothuajse të njëjtin nivel si demonstrata e 11-26 marsit kishte gjatë gjithë muajit prill deri në fund të majit. Demonstrata u shpërnda me një ndërhyrje të madhe nga forcat policore. Sipas të dhënave zyrtare të asaj kohe, gjatë këtyre demonstratave pati 9 të vrarë dhe 15 të plagosur, ndërsa shumë të tjerë brutalisht të rrahur dhe të maltretuar. Kërkesat për më shumë të drejta vazhduan edhe më vonë përmes protestave dhe grevës së minatorëve në shkurt të '89-ës. Në po këtë vit, në Kuvendin e Kosovës në Prishtinë nën një rrethim policor, u suprimua autonomia e Kosovës, duke u vendosur përsëri nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Republikës së Serbisë.

Ndër organizatorët e protestave ishin edhe pjesëtarët e grupeve të ndryshme ilegale që vepronin, së paku, nga mesi i viteve '50 e që njihen si Lëvizja Ilegale. Sipas burimeve jugosllave, pas demonstratave të vitit 1981, së paku 617 shqiptarë u akuzuan për veprimtari irredentiste dhe nacionaliste, 89% prej këtyre u dënuan prej një deri në 15 vjet burgim.

Vitet e 90-ta dhe fillimet e pluralizmit politik në Prishtinë

Autonomia e Kosovës u mor në vitin 1989. Në këtë periudhë intelektualët shqiptarët e formuan partinë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të udhëhequr nga Ibrahim Rugova në Prishtinë. Me 2 korrik 1990, delegatët e Kuvendit të Kosovës, të mbled-

hur para ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, pasi që nuk u ishte lejuar hyrja brenda në sallën përkatëse, e miratuan Deklaratën Kushtetuese për pavarësimin e Kosovës nga Serbia dhe shpalljen e Kosovës Republikë në kuadër të Jugosllavisë. Regjimi i Millosheviqit që u instalua në Kosovë i suprimoi të gjitha institucionet shtetërore: i përjashtoi nga puna të gjithë punonjësit shqiptarë, e mbylli Universitetin e Prishtinës në gjuhën shqipe, i mbylli shkollat e mesme dhe disa fillore për studentët dhe nxënësit shqiptarë, te Radiotelevizioni i Prishtinës (RTP) e përjashtoi stafin shqiptar. Kjo periudhë shënon krijimin e ashtuquajtur “sistemi paralel” si rezistencë paqësore ndaj sategimit që ishte imponuar. Në këtë sistem, institucionet shëndetësore dhe arsimore u bartën në shtëpi private të shqiptarëve, ndërkaq Radio Televizioni i Shqipërisë jepte dy orë program paralel të RTP-së në shqip, program të cilin shqiptarët në Kosovë po e ndiqnin përmes antenave satelitore.

Deri në fundin e viteve '90, shumica e lagjeve të qytetit të Prishtinës, në ballkonet dhe kulmet e shtëpive shqiptare kishte antena satelitore të bardha që, po ashtu, shënjonte qytetin etnikisht. Vetëm në Prishtinë, mbi 7.000 emra rrugësh, shkollash dhe institucione shënjohen ndryshuar dhe zëvendësuar me emra nga historia serbe. Në këtë valë, u ndryshuan edhe bustet e memorialët dhe, po ashtu, u zëvendësuan me memorialë të figurave politike dhe religjioze të historisë serbe. Segregimi etnik po shfaqej edhe në

organizmin e qytetit. Shqiptarët ishin përjashtuar edhe nga klubet sportive dhe stadiumet, duke krijuar nevojë për formim të ligave paralele në të gjitha disiplinat sportive, me ndeshje të zhvilluara në livadhe dhe hapësira të improvizuara. Duke qenë të përjashtuar edhe nga spitalet dhe ambulancat, shtëpi dhe ambiente të improvizuara u kthyen në ambulanca mjekësore në shërbim të popullatës shqiptare.

Me situatë të re politike dhe ekonomike, diaspora shqiptare merr rol të ri ekonomik dhe politik për qytetarët e Kosovës. Në situatën e rënduar ekonomike, për ta siguruar mbijetesën, grumbulloheshin ndihma humanitare e financiare, veçanërisht përmes taksës 3% që mblidhej në sistemin paralel, e ku diaspora dha kontributin më të madh. Në vitin 1991 midis 26 dhe 30 shtatorit, në një referendum të papranuar ndërkombëtarisht, u mor vendim për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Kjo rezultoi me formimin e një qeverie nën udhëheqjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila qeveri, për shkak të shkak të situatës politike, por edhe me qëllim të lobimit për çështjen shqiptarë në botë, u detyrua ta lëshonte Kosovën. Kjo bëri që kjo qeveri të njihet si 'qeveria në ekzil'.

Në vitin 1997 studentët e Universitetit të Prishtinës kishin filluar përgatitjet e tyre për një protestë masive paqësore ku do të kërkohej e drejta për arsimim në objektet shkollore dhe universitare në Kosovë. Protestës i parapriu një seri shëtitjesh në korzonë e qytetit. Kjo pjesë – sheshi i sotëm prej Grandit deri te

Qeveria, e njohur si 'korza', në vitet '70 ishte e shëtitorja më e frekuentuar. Më 1 tetor 1997, data kur fillon semestri universitar, studentët të veshur në këmisha të bardha, u mbloodhën në lagjen Velania për të protestuar paqësisht. Kjo lagje, në vitet e sistemit paralel ishte ndër lagjet që kishte lëshuar shumë shtëpi për të mbajtur mësim fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Ushtria serbe ndërhyri dhunshëm ndaj protestuesvet paqësorë dhe në tentim për shpërndarjen e saj, lëndoi edhe arrestoi shumë studentë përfshirë organizatorët e saj.

Demonstratat patën mbulim nga shumë medime ndërkombëtare, duke e shtuar vëmendjen e publikut për situatën në Kosovë. Lëvizjen paqësore, e cila ishte ideologjia që e karakterizonte këtë dekadë, gratë dhe studentët e kthyen në lëvizje paqësore aktive. Në vitin 1996, gratë u organizuan kundër vrasjes së studentit Armend Daci, i cili rrugës për në shtëpi, u vra nga një civil snajperist serb. Në mbamëndje ngel 'Marshi i bukës' në vitin 1998 ku gratë intelektuale, aktiviste për barazi gjinore, gratë nga Forumi i Grave i LDK-së dhe qytetare të tjera, marshuan nga Prishtina me një bukë në dorë për t'u dërguar ushqim grave dhe fëmijëve të zhvendosurve nga shtëpitë e tyre në Drenicë. Kjo ngjarje ishte pas masakrës më 5, 6 dhe 7 mars 1998 ndaj familjes Jasharaj në Prekaz, Drenicë. Marshi protestues dhe humanitar i grave u ndalua në Fushë Kosovë nga policia serbe, duke i detyruar gratë të ktheheshin.

Periudha e Luftës 1998/1999

Pas gati një dekade rezistence paqësore përmes sistemit paralel, në fund të vitit vitin 1997 dhe më intensivisht më 1998, nisën veprimet nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), e cila zhvillonte luftime sporadike në formë guerile. Pas dështimit të një marrëveshjeje paqësore me ndërmjetësim ndërkombëtar, në Rambuje, Francë, mes përfaqësueseve serbë dhe shqiptarë, forcat e NATO-s nisën sulmet ajrore më 24 mars 1999 ndaj Serbisë dhe Malit të Zi me kërkesën për të ndaluar vrasjen dhe represionin ndaj popullit shqiptar në Kosovë.

Gjatë bombardimeve të NATO-s, forcat serbe i intensifikuan sulmet dhe dhunën ndaj popullatës civile shqiptare në Kosovë, duke vrarë mijëra persona dhe duke shpërngulur rreth 1 milion shqiptarë, kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni. Në atë kohë Prishtina, sipas raporteve nga mediet, dukej si qytet fantazmë. Qytetarëve shqiptarë që kishin ngelur në disa lagje ku kishte edhe serbë, policia serbe u kishte dhënë kartonë të gjelbër për të dëshmuar që janë nga Prishtina. Nuk ka një shifër të saktë për numrin e prishtinasve të larguar nga qyteti i tyre në këtë periudhë. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës më 9 qershor mes NATO-s dhe shtetit serb, forcat serbe filluan të tërhiqeshin nga Kosova dhe populli shqiptar i Kosovës të kthehej nëpër shtëpitë e tyre. Dy ditë më vonë, më 11 qershor, forcat serbe do të largoheshin përfundimisht nga Prishtina dhe më 12 nga e gjithë Kosova dhe kjo

shënon një periudhë të re politike dhe sociale për gjithë popullatën.

Pas vitit 1999 dhe pavarësia

Pas çlirimit Prishtina mbetet kryeqytet i KPas çlirimit Prishtina mbetet kryeqytet i Kosovës si protektorat ndërkombëtar që udhëhiqet nga një mision i Kombeve të Bashkuara me emrin United Nations Mission in Kosovo (UNMIK). Protektorati zgjatë deri në vitin 2008 kur Kosova shpallë pavarësinë. Menjëherë pranohet nga SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia duke nisur kështu rrugëtimin e vendit si shtet i pavarur. Që nga 1999 Prishtina ka parë ndryshime të mëdha në infrastrukturë dhe organizim. Për shkak të kërkesës në rritje për dyndje urbane, janë krijuar lagje të reja, ndërkohë që shumë lagje të vjetra të banuara me shtëpi janë riorganizuar në lagje me bane-sa shumëkatëshe.

Vakumi institucional dhe mungesa e sigurisë kishte ndikuar që ndërtimet dhe mbindërtimet pa leje të lulëzojnë në të gjitha pjesët e qytetit. Në vitin 2000, Rexhep Luci, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Hapësinor në Komunën e Prishtinës, është vrarë, pasi, siç dyshohet, kishte urdhëruar rrënimin e një hoteli që po ndërtohej pa leje.

Plani Zhvillimor Urban, si dokumenti më i rëndësishëm i planifikimit të qytetit që nga paslufta është aprovuar më 2013, duke stabilizuar valën e ndërtimeve të reja që po bëheshin në qytet. Disa lagje të reja janë ndërtuar dhe janë në ndërtim qysh atëherë,

Periudha Osmane dhe Paraosmane



Sahat Kulla

Në qendrën historike të Prishtinës, ndodhet Sahatkulla e ngritur në shekullin XIX - një ndër monumentet më të rëndësishme të arkitekturës utilitare në qytet. Struktura me bazë gjashtëkëndëshi, me materiale guri dhe tulla të plota në trup, duke përfunduar me plumb në kulm, ngrihet në një lartësi prej 26 metrash, duke i dominuar ndërtesat historike përreth saj. Në brendi janë shkallët rrethore me rrasa guri me trashësi prej 3cm, ndërsa në pjesën e strukturës së ndërtuar prej tullave, shkallët janë prej druri, çka tregon se kjo pjesë është ndërtuar më vonë. Karakteristikë e kësaj sahatkulle ishte këmbana e vjetër që ndodhej brenda saj. Këtë këmbanë turqit gjatë luftërave të tyre në Moldavi dhe Vllahi e morën si plaçkë lufte dhe e sollën në sahatkullë në Vushtrri, e cila me urdhërin e Jashar Pashës u soll më pas në sahatkullën e qytetit të Prishtinës. Këmbana ishte e dekoruar me numër të madh të ornamenteve të ngjashme me gjethet e ahut dhe kishte mbishkrim rumun nga viti 1764 i vojvodës Jan Moldovanit, me shkronja më gjatësi 2 cm që shtriheshin gjatë gjithë sipërfaqes së kambanës. Më 2001, këmbana e Sahatkullës është vjedhur dhe është zëvendësuar nga trupat e KFOR-it me mekanizëm elektrik.

Hamami i Madh

Hamami i Madh daton që nga shekulli XV dhe është një nga monumentet më të vjetra dhe më reprezentative të trashëgimisë kulturore të Prishtinës. Gjendet shumë

afër monumenteve të tjera të rëndësishme në pjesën e vjetër të qytetit dhe dikur ishte pjesë themelore e kompleksit të Xhamisë së Mbretit, e cila bashkë me hamamin u ndërtua nga Sulltan Mehmet II Fatihu. Sipas legjendave, thuhet se Sulltan Mehmet II Fatihu i kishte urdhëruar të gjithë punëtorët që punonin në ndërtimin e xhamisë së Mbretit që për çdo ditë të laheshin në hamam. Ky objekt është ndërtuar si “Çift Hamam” që do të thotë se shfrytëzohej nga gratë dhe burrat në të njëjtën kohë. Ndërtesa përbëhej nga paradhoma qendrore, një hapësirë kalimtare ngrohëse dhe banja me një kazan për ruajtjen e ujit, e cila ishte e mbuluar me 18 kupola. Karakteristikë e veçantë e këtij hamami janë mu këto kupolla, të cilat kanë vrima të vendosura në to që e mundësojnë depërtimin e dritës brenda hapësirës. Ngrohja në hamam është bërë përmes avullit në hipokauste të vendosura nën dysheme të mermerit. Hamami është përdorur për breza të tërë nga prishtinasit për pastrim dhe relaksim dhe, shpeshherë, brenda ka pasur ushqim dhe çaj. Në rast dasme, nusja përgatitej brenda hamamit dhe i gjithë ky proces përcillej me muzikë. Që nga viti 1960 Hamami nuk ka funksionuar si i tillë. Ndër vite ka pësuar ndryshime të shumta si pasojë e pakujdesisë dhe neglizhencës dhe sot vazhdon të mbetet i pashfrytëzuar. Pavarësisht kësaj, për shumë qytetarë Hamami i Madh vazhdon të mbetet një nga kujtimet më të bukura të kryeqytetit.

Foto në të majtë: Sahat-kulla. Këmbana e kësaj kulle ka qenë nga Rumania dhe sipas shënimeve daton nga shekulli 18. Në vitin 1999, pas luftës në Kosovë është vjedhur. Ende nuk e dijmë ku është sot.

Hamami i Vogël

Sot kanë mbetur vetëm rrënojat nga Hamami i vjetër, i cili u zhduk gjatë valëve të njëpasnjëshme të ndërtimeve urbane pas Luftës së Dytë Botërore. Dikur ai gjendej pranë Xhamisë së Çarshisë. Gërmadhat e tij u zbuluan gjatë ndërtimit të ndërtesës së sotme të Qeverisë dhe janë konsideruar si shembuj të rëndësishëm të arkitekturës së hershme urbane osmane. Thuhet se ky hamam është ndërtuar në shekullin XV, në të njejtën kohë sikurse dhe hamami i madh i qytetit. Karakteristikë e këtij hamami ishte mënyra e furnizimi të ujit të nevojshëm për banjo, kur dihet se në atë kohë nuk ka pasur ujësjellës. Supozohet se ujërat janë sjellë nga pylli i Gërmisë, nëpërmes kanaleve, kurse nxemja qendrore është siguruar përmes 'ngrohtores' me qymyr druri. Brendia e këtij hamami ishte e stilit oriental, ku dominonin krojet (kurnet) me sahanë të posaçëm prej alumini ose bakri. Në pjesën qendrore të hollit të 'Hamamit të Vogël' gjendej shatërvani me një numër krojesh, i cili krijonte një efekt freskues, ndërsa rreth vetë shatërvanit ekzistonin sirtarë druri, në të cilët kishte pije freskuese, të ftofta për shfrytëzuesit e banjos. Kishte dhe raste kur dhëndurët në prag të martesës, përmes ceremonive gjegjëse dhe larjes, shënonin ngjarjen në mesin e shokëve me muzikë dhe hare.

Xhamia e Sulltan Mehmetit

Xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut II, e njohur edhe si Xhamia e Mbretit apo Xhamia



e Madhe gjendet në bërthamën e qytetit të vjetër të Prishtinës, në afërsi të monumenteve të tjera të trashëgimisë kulturore. Është ndërtuar sipas urdhrit të Sulltan Mehmet Fatihut II - Pushtuesit. Sipas mbishkrimit në gjuhën arabe që ndodhet mbi portalin e hyrjes, xhamia është ndërtuar në vitin 1461. Gjatë luftërave austro-turke në fund të shekullit XVII, kjo xhami është shndërruar në kishë katolike. Këtu ka qenë i varrosur Pjetër Bogdani, njëri ndër shkrimtarët më të hershëm shqiptarë. Pas humbjes së luftës së austriakëve në vitin 1690 eshtrat e Bogdanit zhvarrosen dhe hidhen në rrugë nga ushtria turke dhe ndërtesës i kthehet funksioni i mëparshëm. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtria gjermane ka bërë disa intervenime në brendinë e xhamisë. Kjo shihet nga pikturimi i kryqit të thyer mbi portën e hyrjes. Karakteristikë e kësaj xhamie janë muret e trasha

Qendra Historike e Prishtinës, me gjithë degradimin, vazhdon të ruaj konturat e vjetra të qytetit.

rreth 180 cm dhe kupola e saj që njihet si më e madhja në Gadishullin Ballkanik. Për vlerat artistike të kësaj ndërtese, shquhet sidomos mahvili i drurit i zbukuruar me friz në formë stalaktitesh dhe me ornamente gjeometrike. Enterieri në përgjithësi dominon me piktura me ngjyra të larmishme me motive bimore në teknikën al-seko. Ky monument ka pësuar një sërë ndërhyrjesh riparuese, ndër të cilat vlen të përmendet restaurimi i viteve 1682/83 – gjatë sundimit të Sulltan Mehmetit IV, si dhe ndërhyrjet riparuese pas tërmetit të vitit 1955. Që nga koha kur ky monument është shpallur nën mbrojtje të shtetit (1953) nga Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve, xhamia ishte në gjendje jo të mirë, prandaj gjatë viteve 1955 dhe 1990 nga i njëjti institucion janë realizuar ndërhyrje të pjesshme konservimi me karakter shpëtimi. Konservimi i fundit i ndërtesës është bërë në vitin 2010 nga TIKA (Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim). Xhamia së bashku me oborrin e saj, sot është një pikë fokale për mbledhjen e komunitetit. Në oborrin e xhamisë gjendet një shadërvan i madh me 14 gypa kroje, i ndërtuar në një fazë më të vonshme se vetë xhamia. Dikur, në këtë oborr gjendeshin edhe disa varre të besimtarëve islamë me merita të veçanta.

Xhamia e Jashar Pashës

Xhamia e Jashar Pashës është xhamia më e vonshme e ndërtuar në zonën historike të Prishtinës. Sipas të dhënave të shkruara, ndërtimi i kësaj xhamie daton që nga shekulli

XV, derisa pamja e saj kryesisht daton nga shekulli XIX, më saktësisht viti 1834. Kjo përkon me kohën kur Jashar Pasha, si qytetar i pasur i Prishtinës dhe guvernator i Shkupit, ka financuar realizimin e riparimeve rrënjësore të kësaj xhamie dhe që nga ajo kohë xhamia mban emrin Xhamia e Jashar Pashës.

Ndërtesa ka planimetri katrore, me strukturë guri të tipit njëkupolësh, me portik druri të tipit të hapur dhe minare prej guri. Enterieri paraqet një hapësirë unike të ndriçuar përmes dritareve të radhitura në nivele, me mure të pikturuara dhe në përbërje ka mahvilin, mimberin dhe mihrabin. Fasada e pjesës hyrëse dhe tavani nga druri i hajatit, po ashtu, janë të dekoruara me motive bimore. Minarja dhjetëkëndëshe e vendosur pranë xhamisë ka dekorim skulptural në pjesën e poshtme dhe ka sherefen elegante të vendosur në pjesën e sipërme. Pas dëmtimeve që ka pasur për një kohë, kjo xhami është restauruar në vitin 2016 nga TIKA.

Xhamia e Çarshisë

Xhamia e Çarshisë, njëherazi ndërtesa më e vjetër që ekziston sot në Prishtinë, shënon fillimin e qendrës së qytetit të vjetër. Në të kaluarën kjo xhami ndodhej përballë çarshisë së mbuluar që dikur kishte Prishtina. Menjëherë pas Betejës së Kosovës më 1389, Jil-dirim Bajaziti në emër të fitores së ushtrisë turke, e vuri gurthemelin e kësaj xhamie, ndërsa punimet përfundimtare i ndërmori Sulltan Mehmeti II Fatihu. Qytetarët i referoreshin kësaj xhamie edhe me emra të tjerë



Ndërtesa më e vjetër në Prishtinë. Viti kur ka nisur të ndërsohet besohet se është 1382.



ProCredit



Ay ki githma
gij mabsh

RESTAURANT ANORA

BENI



**Prishtina është
qyteti më i
populluar në
Kosovë.**

si 'Sagër Xhamie', 'Muradija Xhamia', 'Çarshi Xhamia' dhe 'Tash Xhamia'.

Xhamia me bazë katrore është njëhapësinore, me minare të ndërtuar tërësisht nga guri. Minarja është në fakt karakteristika kryesore e kësaj xhamia, e cila per faktin që është ndërtuar e tëra nga gurët, e dallon nga të tjerat. Xhamia kufizohet me oborr shumë të ngushtë në hyrje të saj, nën vetë minaren, gjendej edhe varri i 4 luftëtarëve të rënë në Betejën e Kosovës. Hapësira e brendshme ndriçohet nga dritaret e radhitura në nivele të ndryshme me ritëm të theksuar, sipërfaqet e mureve janë të dekoruara me piktura murale me motive bimore, orientale të asaj kohe. Gjatë kohës, xhamia në brendi, jashtë dhe në rrethinën e saj ka pësuar ndërhyrje riparuese dhe transformime, të cilat e kanë ndikuar integritetin pamor të saj, ndërsa minarja e saj mbetet e patransformuar nga forma origjinale.

Xhamia e Llapit

Xhamia e Llapit, e njohur edhe si Xhamia e Ramdanisë, ndodhet në pjesën periferike veriore të qendrës së vjetër të qytetit të Prishtinës. Sipas dokumenteve të gjetura deri më tani, thuhet se Xhamia e Llapit ishte ndërtuar në vitin 1470. Mirëpo, në vitin 1996 në oborrin e xhamisë është gjetur një pjatë e mermerit, e cila shpie në një datë tjetër të ndërtimit (Hixhri 959, pra 1551 i erës sonë). Sipas një udhëtari anonim, është thënë që xhamia ka nisur fillimisht të ndërtohet si kishë. Kur ndërtimi i minares filloi, kato-

likët e shkatërruan atë dy herë gjatë natës. Xhamia vazhdimisht funksiononte si një vend i adhurimit dhe lutjes deri në vitin 1999, kur edhe u dogj dhe më pas u braktis.

Xhamia e Llapit ka edhe një oborr me mure rrethuese në veri dhe në perëndim si dhe shatërvanin për "abdes" - pastrim para ritualit të namazit. Struktura me bazë drejtëkëndëshi ka mure të ndërtuara nga gurët ranorë të gdhendur dhe të mbështjellë me llaç. Minarja ishte ndërtuar në të njëjtën mënyrë. Brendësia e xhamisë karakterizohet me murale shumëngjyrëshe, ku dominojnë motivet me lule. Gjatë restaurimit në vitin 1980, xhamia ka pësuar disa ndryshime në eksterier, enterier dhe oborrin e saj. Gjatë viteve 2009- 2010 është bërë konservimi i xhamisë, e cila ishte dëmtuar rrënjësisht nga lufta e fundit në Kosovë. Gjatë këtij konservimi, monumentit i janë kthyer shumë elemente origjinale.

Shatërvani i Qytetit

Shatërvani i qytetit gjendet në kompleksin e Prishtinës së vjetër, konkretisht në oborrin e Xhamisë së Çarshisë. Ky shatërvan i dekoruar nga mermeri paraqet objektin e vetëm publik të llojit të këtillë në Prishtinë që ka mbijetuar deri më sot. Në bazë të llojit të ndërtimit dhe dekorimit prej mermeri, mund të thuhet se shatërvani është ndërtuar në fund të shekullit XVII ose fillim të shekullit XVIII. Zakonet kanë kushtëzuar që arkitektura islame të ndërtonte shatërvanë në qendër të hapësirave publike, afër ndërte-



Shatërvani i qytetit daton nga shekulli XV.

save të tjera fetare. Në të kaluarën, dhjetëra shatërvanë të ngjashëm publikë kanë qenë të shpërndarë nëpër qytet. Besimtarët myslimanë kanë përdorë shatërvanin për abdes, kurse një pjesë e qytetarëve të Prishtinës e kanë përdorur për ujë të pijshëm. Uji në këtë shatërvan para një dekade e më shumë ka ardhur nga burimet e Gërmisë, me gypa nëntokësorë. Shatërvani sot furnizohet me ujë të ujësjellësit të qytetit të Prishtinës. Uji rrjedh nga shatërvani në pllakë të betonit, e cila është e rrethuar me 6 pllaka të mermerit me lartësi 77 cm dhe gjerësi 80 cm. Pllakat janë të dekoruara me rozeta dhe dekore të tjera. Shatërvani ka ruajtur vetëm një pjesë të autenticitetit të tij. Në secilën pllakë të mermerit vërehen vrima në mes, të cilat tregojnë se në të kaluarën shatërvani ka pasur zhvillim më të gjerë, mirëpo ngritja e nivelit të rrugës ka mbuluar pjesë të tjera të tij.



**Kompleksi
Emin Gjiku.**

Kompleks banimi Emin Gjiku

Ansambli "Emin Gjiku", pronë e familjes së njohur Gjinolli, është ndërtuar në fillim të shekullit XIX. Emri vjen nga nofka e Emin Gjinollit, "burrë i vogël", ose në turqisht Eminçik, që më vonë u shndërrua në Emin Gjiku, prej nga edhe e merr emrin kompleksi. Ky ansambël përbëhet nga dy oborre të mëdha: oborri në hyrje me stallë dhe me ndërtesë guri dhe oborri i brendshëm, në të cilin ndodhet shtëpia e familjes, shtëpia e mysafirëve dhe shtëpia e shërbëtorëve. Deri në vitin 1990, ky kompleks është përdorur si Muze i Natyrës, ndërsa nga viti 2003

kompleksi funksion si Muze Etnologjik, i cili përmban koleksione të ndryshme të trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe shpirtërore. Ndërtesa e gurit, e rivendosur aty në vitin 1960, është e vetmja ndërtesë, e cila i shpëtoi shkatërrimit të Çarshisë së Vjetër. Është ndërtesë njëkatëshe e mbuluar me kulm guri, dikur dyqan farkëtari, aktualisht qendër e artit bashkëkohor e quajtur "Stacion". Oborret janë të rrethuara me mure të larta, të ndërtuara me qerpiqë dhe hatulla nga druri. Shtëpitë dhe stalla pasqyrojnë harmoni arkitekturale të proporcioneve dhe të elementeve arkitektonike. Gjatë periudhave të ndryshme kohore, kompleksi ka pësuar ndryshime të shumta si pasojë e ndërrimit të funksionit. Por si tërësi, kompleksi "Emin Gjiku" mbetet një ndër shembujt më të mirë të shtëpive qytetare të fillimit të shekullit XIX.

Në shtator 2006, Emin Gjiku hapet si muze, pjesë përbërëse e Muzeut të Kosovës me ekspozitën etnologjike që shpjegon jetën në Kosovë në aspektin etnologjik gjatë shekujve XVIII-XIX.

Ish Akademia e Shkencave dhe e Arteve

Shtëpia e banimit – ish-Akademia e Shkencave dhe e Arteve, daton që nga shekulli XIX dhe paraqet shembull të rrallë të arkitekturës së vjetër qytetare të banimit. Të dhënat flasin se shtëpia ishte njëra prej bujtinave të shumta në Prishtinë, pronë e Tefik Rushit Mirashit dhe e familjes Domaniku. Gjatë viteve 1964-1965 për shkak të rrezikimit dhe dëmtimeve të mëdha, kjo shtëpi

është rikonstruktuar në tërësi me material të ri, ku prej dy njësive të veçanta të shtëpive është bërë një tërësi. Përveç kësaj janë bërë edhe disa ndryshime në funksion për shkak të adaptimit të saj nga funksioni primar i shtëpisë së banimit në hapësira për zyre. Hapësirat e kësaj ndërtese gjatë një periudhe kohore janë përdorur nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, kurse sot përdoren si zyre të Shoqatës të të Burgosurve Politikë. Struktura e ndërtesës me bazë drejtëkëndëshi ka mure masive me trashësi 38 cm, të ndërtuara prej tullës së plotë, përveç dy pjesëve të murit, të cilat janë prej gurit të papërpunuar. Përdhesa është e mbyllur nga të dy rrugët dhe ndriçimi mundësohet nga oborri. Konstruksioni i çardakut mbështetet në gjashtë shtylla autentike të vendosura në shtylla të betonit, që kanë lart jastëkun e drurit. Kati i parë ka gjashtë hapësira që kanë qasje direkte nga çardaku. Konstruksioni i meskatit është bondruk me mbushje prej tullave poroze. Karakteristikë e kësaj shtëpie janë edhe grilat nga druri, musharabijet, të vendosura në dritaret me korniza nga druri.

Kombi dhe kombësia

Pas LDB, më 1948, u ndërpre në kontaktet me Shqipërinë si pasojë e shkëputjes së marrëdhënieve Jugosllavi-Shqipëri duke rezultuar me ndryshime të mëdha për Prishtinën si kryeqytet. Shqiptarët në Kosovë njiheshin si pakicë pa të drejta si kombet dhe kombësitë e tjera. Me Kushtetutën e 7 prillit 1963, Republika Federale Popullore e Jugosllavisë (RFPJ)

Periudha moderne

shndërrohet në Republikë Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ), ndërkaq Kosova njihet si Krahinë Socialiste Autonome (KSA). Shqiptarët nga nocioni 'pakicë kombëtare' me këtë Kushtetutë u definuan si 'kombësi'.

Ferexheja

Në këtë periudhë, u organizuan dy fushata me rëndësi të veçantë, nga Fronti Antifashist i Grave (FAG). I dalë nga lufta nacional çlirimtare kundër fashizmit dhe partisë komuniste jugosllave, FAG-u kishte për qëllim arsimimin dhe emancipimin e grave. Përpjekjet për t'u realizuar këto synime u bënë përmes fushatës për heqjen e ferexhesë dhe organizimin e kurseve për alfabetizëm. FAG-u nxorri edhe shtypin e vet, Buletinin dhe më vonë revistën "Agimi", artikujt e së cilave promovonin çlirimin e grave përmes heqjes së ferexhesë, arsimimin e grave, pastaj këshillat për nënat e reja dhe këshilla amvisërie. Këto dy fushata të organizuara paralelisht hasën në rezistencë nga shtresa të ndryshme të shoqërisë, sidomos të grupeve më religjioze. Më 21 mars 1950, kaloi ligji që ndalonte ferexhenë apo çfardo mbulimi të fytyrës.

Ilegalja e Kosovës

Si përgjegjës për organizimin e demonstratave në vitet '60 u konsideruan pjesëtarët e grupeve të ndryshme ilegale që vepronin së paku nga mesi i viteve të 1950, e që njihen si Lëvizja Ilegale. Programi politik i kësaj lëvizjeje qe vepronte në grupe zakonisht nga tre anëtarë, ndryshonte varësisht nga rrethanat

e kohës. Përderisa në fillim programi thirrte për të drejtën për vetëvendosje, në vitet '80, kërkesa kryesore ishte Kosova Republikë dhe thirrje kundër shtypjes dhe diskriminimit jugosllav e pastaj serb ndaj shqiptarëve. Vepriktaria e lilegales, përveç organizimit të demonstratave, nënkuptonte shkruarjen e parullave, përgatitjen e fletushkave me artikuj informues e emancipues kombëtarë. Në qytetin e Prishtinës, ato shpërndareshin nëpër rrugë e rrugica. Policia kishte vënë në shënjestër aktivistët politikë të këtyre grupeve, të cilët ishin nën vëzhgim dhe ndiqeshin. Ish-anëtarë të lilegales dhe ish-të burgosur politikë, tregojnë që ikja prej policisë nganjëherë ka ndodhur duke kaluar mbi kulmet e shtëpive apo deriçkat e oborreve në pjesën e vjetër të qytetit, por edhe dukeu fshehur në varrezat e qytetit.



Terminali i ri i Aeroportit të Prishtinës është ndërtuar në vitin 2009.

Rusët në Aeroportin e Prishtinës

Me datën 12 qershor 1999, trupat e NATO-s kanë hyrë në Prishtinë. Por një ngjarje që kishte ndodhur ato ditë ishte zbarkimi i trupave speciale ruse në Aeroportin e Prishtinës, ku siç transmeton gazeta britanike "The Guardian", rreth 200 ushtarë rusë e kishin bllokuar Aeroportin e Prishtinës dhe me të ardhur kontingjenti i parë i trupave të NATO-s në Prishtinë, të kryesuar nga ushtarë britanikë dhe që ishin dikund rreth 800, filluan tensionet mes palëve që mund të çonin krizën në një nivel krejt tjetër, nga një luftë shqiptaro-serbe në një tjetër botërore. Pas një heshtjeje zyrtare, më në fund Kremli pranoi

që ky kontingjent i trupave ruse është dërguar si një kundër-përgjigje ndaj vendimeve të NATO-s për të mos e përfshirë Rusinë si pjesë përbërëse të paqeruajtësve në Kosovë. Kriza u mënjanua edhe pse pati tensione sporadike mes dy palëve: britanikëve dhe rusëve, kështu Aeroporti i Prishtinës iu dorëzua kontingjentit britanik dhe NATO-s.

Muzeu i Kosovës

Ndërtesa monumentale eklektike "Muzeu i Kosovës" gjendet në zonën historike të qytetit të Prishtinës. Ndërtesa është ngritur më 1885/86 sipas projektit të punuar në Zyrën Ushtarake në Graz, si ndërtesë për stafin e garnizonit osman. Deri në vitin 1975 ndërtesa është përdorur si seli e komandës ushtarake gjatë regjimit të ish-RSFJ për rajoinn e Prishtinës. Prej vitit 1980, kjo ndërtesë shfrytëzohet si Muze i Kosovës. Planimetria e ndërtesës është drejtkëndëshe e ndërtuar me materiale ndërtimore si gurë, tulla, dru e mermer. Kullmi është rindërtuar dhe i takon tipit "mansard" i mbuluar me tjegulla "moderne". Pjesa frontale e ndërtesës theksohet me një ritëm të njëtrajtshëm të hapjeve dhe shkallëve të theksuara simetrike njëkrahëshe, me planimetri gjysmëharkore që çojnë nga përdhesa deri në kat të parë. Në oborrin e muzeut dikur ka ekzistuar edhe Sahatkulla e Vjetër. Muzeu i Kosovës si institucion është themeluar në



Muzeu Kombëtar ekspozohet në ndërtesën e fundit të shekulli 19-të, që është ndërtuar nga Shteti Osman, në stil të ndërtesave austriake të kohës.

vitin 1949. Nga viti 2018, Muzeu përfshin koleksionin e ekspozitës permanente me një koleksion të gjërë të trashëgimisë kulturore të vendit, me eksponatet e pavionit të arkeologjisë—prej kohës së Neolitit e deri në Shpalljen e Pavarësisë në vitin 2008.

Kampusi universitar

Universiteti i Prishtinës është themeluar me Ligjin mbi Themelimin e Universitetit të Prishtinës, të cilin e miratoi Kuvendi i Kra-hinës Socialiste të Kosovës, më 18 nëntor 1969. Themelimi i Universitetit të Prishtinës ishte ngjarje historike për popullin e Kosovës, si edhe për mbarë kombin shqiptar. Të gjitha këto ndryshime u reflektuan natyrshëm edhe në zhvillimet urbane dhe arkitektonike sidomos në kryeqendrën e saj, Prishtinën. Kuvendi themelues i Universitetit të Prishtinës u mbajt më 13 shkurt 1970, kurse dy ditë më vonë, më 15 shkurt 1970, u mbajt edhe mbledhja solemne e Kuvendit dhe pikërisht kjo datë u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës. Në përbërje të Universitetit të Prishtinës të posathemeluar ishin këto fakultete me seli në Prishtinë: Fakulteti Filozofik, Fakulteti Juridiko-Ekonomik, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Mjekësisë. Tani Universiteti i Prishtinës i ka 17 fakultete, nga të cilat 14 janë fakultete akademike, ndërsa 3 janë fakultete të shkencave të aplikuara. Në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës është organizuar puna universitare dhe kanë shërbyer të gjithë rektorët që nga koha e themelimit më 1970.

Hotel Grand

Hotel "Grand" Prishtina, hotel i kategorisë A me pesë yje, është hoteli i parë i këtij lloji, jo vetëm në Prishtinë, por edhe në tërë Kosovën. Në kohën e hapjes së tij në prill të vitit 1978, ishte hoteli më modern dhe me kapacitet më të madh në atë kohë në Prishtinë. Hotel "Unioni" dhe Hotel "Bozhuri" ishin hotele që tanimë funksiononin në Prishtinë, por jo me përmasa të Hotel "Grand" Prishtina. Me vëllimin dhe pozitën e tij përfaqëson një prej pikave referuese më karakteristike të Prishtinës, pa të cilin, silueta e Prishtinës nuk do të ishte e njejtë. Është një prej veprave më të rëndësishme të arkitektit të parë shqiptar në Kosovë, Bashkim Fehmiu. Silueta e ndërtesës, organizimi dhe kompozimi i masave të tij, i japin fizionomisë së përgjithshme të kësaj pjese të qytetit një dimension të ri. 'Grandi' siç qytetarët i referohen objektit, pasqyron arkitekturën moderne socialiste të viteve '70-'80, ashtu si shumica e ndërtesave të qendrës së Prishtinës. Në ambientet luksoze të tij janë realizuar takime të niveleve të ndryshme politike e kulturore dhe festat e fundvitit apo të tjera ngjarje kulturore e argëtuese. Po ashtu, ka shërbyer dhe ende shërben si vend takim në sheshin përballë saj: "Takohe mi te Grandi".

Teatri Kombëtar i Kosovës

Në fillim me emrin Teatri Popullor Rajonal e pastaj Teatri Popullor Krahinor u themelua me vendim të Kuvendit të ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në tetor të vitit

Ndërtesa e Teatrit Kombëtar të Kosovës.





Prishtina natën.

1946 në Prizren. Ky ishte institucioni i parë teatror profesionist në Kosovë pas Luftës së DytëBotërore. Disa muaj pas themelimit, ky teatër u transferua në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Shfaqjet e para të këtij teatri janë punuar kryesisht nga artistët amatorë, entuziastë e idealistë të talentuar, të ndihmuar nga artistët profesionistë nga hapësira të tjera të ish-Jugosllavisë, ndërkohë që në vitet '60, ansambli i tij pasurohet me kuadro të reja profesioniste.

Më 7 maj 1949, me shfaqjen "Gishti para hundës" (Prst pred nosom) të dramaturgut Jozho Horvat, u hap solemnisht Teatri në Prishtinë. Repertori i këtij teatri është ndërtuar mbi tekstet e shumta të dramaturgjisë kombëtare, botërore dhe ish-jugosllave. Shfaqjet e këtij teatri, të cilat janë prezantuar nëpër festivale të ndryshme me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar në ish-Jugosllavi, janë vlerësuar me tone të larta nga kritika e atëhershme dhe janë nderuar me çmime të ndryshme artistike. Kështu, p.sh. në vitin 1967, shfaqja "Erveheja" e regjisorit Muharrem Qena është nderuar me Çmimin e Regjisë më të Mirë në Festivalin e Dramës Jugosllave "Sterijino Pozorje". Krahas shfaqjeve në gjuhën shqipe, janë realizuar edhe shfaqje në gjuhën serbe. Sidomos pas vitit 1981 e këndej, ky teatër ka vepruar nën presion të rëndë politik nga sistemi dhe regjimi komunist jugosllav.

Në vitin 1990, administrata e dhunshme që u instalua në këtë kohë nën regjimin e Millosheviqit, dëboi nga teatri shumë nga ar-

tistët shqiptarë. Gjatë kësaj periudhe, në një sistem arsimor paralel të krijuar në kushtet e rezistencës aktive paqësore kundër regjimit serb, nëpër shtëpitë-shkolla u krijuan shumë nga kuadrot artistike, të cilat tash më janë pjesë e ansamblit profesionist të këtij teatri. Në vitin 1999, pas mbarimit të luftës në Kosovë, teatri emërohet në Teatri Kombëtar i Kosovës. Gjatë 16 viteve të pas luftës, në këtë teatër janë vënë në skenë tekste të shumta të dramaturgjisë kombëtar edhe botërore.

Baleti i Kosovës

Trupa e parë e Baletit të Kosovës është formuar më 1972. Valltarët e parë të kësaj trupe janë arsimuar në shkollën e lartë të baletit në Shkup, nën udhëheqjen e Tatjana Petkovskas. Fillimisht 25 vallëtarë kanë diplomuar nga kjo shkollë (6 femra, 19 meshkuj). Baleti i Kosovës është themeluar nën ombrellën e Teatrit Kombëtar të Kosovës. Ndër valltarët e parë ishin Ahmet Brahimaj, Rustem Selca, Elez Nikçi, Asma Mulla, Jonuz Beqiraj, Hysen Podrimçaku, Rustem Bajrami, Isa Bajraktari, Gani Shala. Drejtori i parë i trupës së baletit ishte emëruar Abdurrahman Nokshiqi.

Biblioteka Kombëtare

Një nga veprat më të rëndësishme të viteve '70 në Prishtinë është Biblioteka Kombëtare e Kosovës, e projektuar nga arkitekti kroat Andrea Mutnjaković. Kjo bibliotekë, kurorëzoi aktivitetin e deriatëhershëm bibliotekar në Prishtinë dhe Kosovë përgjithësisht.

Institucioni i parë bibliotekar qendror në Kosovë u themelua në Prizren në dhjetor 1944. Më 1947, Biblioteka rajonale zhvendoset në Prishtinë. Më 1952, ndërpritet veprimtaria dhe fondet e Bibliotekës barten në bibliotekën e qytetit "Miladin Popoviq" në Prishtinë. Në vitin 1956, themelohet Qendra bibliotekare e KAKM-së që kishte veprimtari administrative, ndërkaq me vendimin e Këshillit Krahinor, më 1961, themelohen bibliotekat rajonale. Kjo bëhet pas nxjerrjes së Ligjit nga RP e Serbisë për bibliotekat, me të cilin njësitë politiko-territoriale obligohen që t'i përcaktojnë bibliotekat amë. Kjo bibliotekë e nisi punën me kuadrin e Qendrës bibliotekare, e cila e ndërpreu veprimtarinë më 1962.

Në vitin 1970, Biblioteka popullore Krahinore emërtohet Biblioteka Popullore dhe Universitare. Për shkak të rritjes së kërkesave për kapacitetin e bibliotekës merret vendim të ndërtohet ndërtesa e re. Ndërtimi i Bibliotekës Kombëtare u bë pjesë e Planit shoqëror të Zhvillimit të Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës përgjatë 1971-1975. Objekti filloi të ndërtohet në gusht 1974 dhe përfundoi në shtator 1981. Më 15 maj 1975 u vu gurëthemeli i ndërtesës së Bibliotekës.

Në vitin 1975, Kuvendi i KSA të Kosovës, nxori Ligjin mbi ndërtimin e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë, dhe në vitin 1982 biblioteka bartet në ndërtesën e re, të diazjnuar nga arktikekti kroat Andrija Mutnjakoviq.

Ky objekt ka dritare zenitale në formë kupolash (gjithsej 73 kupola), sallat e leximit për përdorues me 600 vende (sallën e peridikut dhe sallat e lexuesve për punëtorë shkencorë). Biblioteka Kombëtare e Kosovës është paraparë sipas Zgjidhjes ideore urbanistike - Qendra Universitare në Prishtinë, e punuar nga Enti për urbanizëm dhe projektim, Prishtinë, tetor 1971, me projektues kryesor Ark. Bashkim Fehmiu. Detyrimet dhe propozimet të dala nga ky plan janë marrë në konsideratë vetëm nga arkitekti kroat Andrija Mutnjaković gjatë projektimit të Bibliotekës Universitare, i cili në fakt është i vetmi objekt i ndërtuar bazuar në planin urbanistik të profesorit Bashkim Fehmiu.

Biblioteka aktualisht ka shtatë departamente: 1. Departamentin e përpunimit të materialit bibliotekar me shërbimet përkatëse, 2. Departamentin e koleksioneve të veçanta; 3. Departamentin e bibliografisë; 4. Departamentin e hulumtimit dhe të zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare; 5. Departamentin e informacioneve dhe të shërbimeve bibliotekare; 6. Departamentin e burimeve dhe të shërbimeve kompjuterike, dhe 7. Departamentin e administratës.

Galeria e Arteve

Galeria e Arteve e Kosovës u formua në vitin 1979 si institucion kulturor për prezantimin e artit pamor dhe ruajtjen e mbledhjen e veprave më me vlerë. Themelimi i këtij institucioni u bë domosdoshmëri, sidomos pas formimit të institucioneve arsimore e të artit





**Biblioteka
Kombëtare e
Kosovës, ndër
godinat më të
vizituara në
qytet, nga
turistët.**



Mr. Chat.

si “Shkolla e Mesme e Artit” në Pejë më 1949, “Shkolla e lartë Pedagogjike” në Prishtinë, si dhe themelimi i Akademisë së Arteve më 1973. Sipas të dhënave kjo ndërtesë, e cila tani shërben si Galeri e Arteve, është ndërtuar rreth vitit 1935 dhe, fillimisht, ka shërbyer si kazermë e ushtrisë së ish-Jugosllavisë. Nga viti 1955 ndërtesa ka funksionuar si Bibliotekë deri më 1981, kur u ndërtua ndërtesa e re e Bibliotekës Kombëtare. Nga viti 1982 ndërtesa ka shërbyer për Muzeun e Revolucionit, deri në vitin 1995 kur është adaptuar edhe njëherë për funksion të Galerisë së Arteve. Për këto 39 vjet të veprimtarisë, ky institucion ka organizuar afro 500 ekspozita në vend dhe në botën e jashtme. Salloni i Nëntorit ka qenë një nga ngjarjet më të rëndësishme të artit figurativ në Kosovë.

Biblioteka ‘Hivzi Sylejmani’

Kjo bibliotekë ka filluar të punojë në shkurt të vitit 1945, me një fond prej 1.300 librash në gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe një fond fletushkash dhe broshurash të kohës së luftës. Pas ndalimit të punës së Qendrës bibliotekare më 1953, fondi i koleksionit librar i është shtuar kësaj biblioteke dhe deri më 1956 ka luajtur rolin e Qendrës bibliotekare për gjithë territorin e Kosovës. Brenda kësaj periudhe Biblioteka e ka zgjeruar rrjetin e bibliotekave jashtë Prishtinës.

Kosova Filmi

Ky institucion ka qenë i themeluar nga Kuvendi i Kosovës më 1969 me qëllim të prodhimit, të shfaqjes dhe të distribuimit të filmave. Drejtor i parë i KosovaFilmit ka qenë Abdurrahman Shala. KosovaFilmi ka prodhuar 9 filma artistikë. Filmi i parë në gjuhën shqipe si prodhim i KosovaFilmit, “Kur pranvera vonohet”, në regji të Ekrem Kyeziut, është bazuar në ditarin e Fadil Hoxhës gjatë kohës si udhëheqës i partizanëve të Kosovës. Ndër filmat më të njohur në shqip si prodhime të KosovaFilmit janë filmat “Proka” dhe “Rojet e mjegullës” në regji të Isa Qosjes.

Muzika rok në vitet ‘60-të dhe ‘70-të

Muzika rok në Kosovë fillon në vitet e 60-ta. Prishtina dhe Mitrovica ishin dy qendrat e kësaj muzike në Kosovë. Rok bendet e viteve të 1960-a në Prishtinë ishin: AVI Modestët, AVI Bozhurët, AVI Tandem, AVI Kodex. Bendet e viteve të 1970-a: AVI Kodex, AVI Autostop.

Rok bendet e viteve të 1980-a

Rryma e muzikës rok ka vazhduar edhe në vitet ‘80-të. Grupet kryesore të atyre viteve në skenën e Prishtinës ishin: “Gjurmët”, “403”, “Lindja”, “Minatori”.

GJURMËT - Grupi u formua më 1981 dhe kishte pesë anëtarë. Vokalisti i grupit ishte Migjen Kelmendi, Armando Gjini në piano, Tomor Kurshumliu bas kitarë, Petrit Riza baterist dhe Bekim Dyla kitarë. Këngët: “Grimi çfarë shije ka”, “Në Prishtinë”, “Të shtrirë mbi

kanape”, “Mendoja çdo gjë merr fund pa ty” etj.

403 - Mentor Gjurgjiali, Fatmir Zajmi dhe Naim Osmani ishin tre shokët që formuan grupin 403 më 1981. Pas pak kohësh atyre iu bashkohen edhe vokalisti Hektor Gjurgjiali, Arben Godanca në kitarë dhe Veton Orana në sint. Këngët “Bohemi”, “Kujtimi”, “A do të kthehet”, “Indeksi” etj.

LINDJA - Grupi Lindja u formua në vitin 1983, nga Luan Osmani, Fatos Berisha e Afrim Maloku. Këngët: “Nata”, “Një bashqe me lule”, “Zvarraniku”, “Por atë e bëjmë”, “Ata nuk bëjnë zë”, “Kulla” etj.

MINATORI - U formua në vitet e 80-ta nga Naser Gjinovci e Mufail Limani. Këngët: “Të dua sa Kosovën”, “Molla me sherbet”, “Udhë e mbarë”. “A thua ëndërr ishe ti”.

Bende dhe artistë të tjera të Prishtinës: Fillimi i fundit, Ilirët, BB Poqi, Bankrot, Vizionet e thyera, Moneyfest, Violeta Rexhepagiq, Iliriana Riza, Trio Rona, Smisao Mašte, Paš ad etj.

Kori Collegium Cantorum

Është themeluar gjatë fillimit të viteve ‘60-të fillimisht si kor gjysmëprofesional. Nën drejtimin e Mark Kaçinarit e me vonë të Gjergj Kaçinarit, Collegium Cantorum ka luajtur rol të madh në formësimin dhe edukimin artistik të shqiptarëve të Kosovës. Që nga fillimi, kori ka luajtur pjesë të rëndë-



sishme të muzikës botërore dhe shqiptare (mesha, madrigal, cantata, rekuuemë etj.). Ky kor, po ashtu, ka luajtur rol të rëndësishëm në punën e Korit të Radio-Televizionit të Prishtinës.

Ansambli Shota

Ansambli kombëtar i këngëve dhe valleve "Shota" është themeluar më 30 shtator 1964, si Ansambël Shtetëror, me vendim të ish-Kuvendit të Krahinës Autonome të Kosovës.

Rilindja

E përditshmja Rilindja për herë të parë ka dalë më 12 shkurt 1945 në Prizren dhe është gazeta e parë në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi. Gazeta shtypet në Shtypshkronjën Shtetërore në Prizren nga numri 1 deri në 60-të. Numri 61 i gazetës faqoset dhe shtypet në Prishtinë në Shtypshkronjën Krahinore të Frontit Popullor. Në fillim ishte e përjavshme vetëm me katër faqe deri më 27 qershor 1948, kur fillon të dalë dy herë në javë, të dielave dhe të enjteve. Pastaj, nga nëntori i vitit 1958 nis të dalë gazeta e përditshme (nuk dilte vetëm të premtëve). Nga viti 1964 del çdo ditë standard në 20 faqe, ndërsa të shtunave dhe gjatë festave 24-32 faqe. Gazeta "Rilindja" ka funksionuar si "organ i pavarur i Lidhjes Socialiste të popullit punonjës të Kosovës", nën ombrellën e Pallatit të shtypit me të njejtin emër ku janë botuar të gjitha veprat letrare, shkencore dhe literaturë shkollore dhe ajo për fëmijë e asaj kohe.

Jeta e Re

Është revistë letrare dymujore, e cila është botuar në kuadër të OPGBG “Rilindja” në Prishtinë. Numri parë i kësaj reviste ka dalë në korrik të vitit 1949, me nismën e Esad Mekullit, i cili ishte kryeredaktori i parë i saj. Është revista më jetëgjatë në historinë e periodikut shqiptar. Drejtor përgjegjës ishte Zekrija Rexha. Revista vazhdon të botohet ende.

Kosovarja

Kjo revistë për herë të parë botohet më 1971. Fokusi i “Kosovares” ishin të gjitha temat që kishin të bënin me shëndetin e grave dhe të fëmijëve, të jetës shoqërore dhe politike të grave, urbane dhe atyre në zonat rurale. “Kosovarja” kishte synim emancipimin e grave dhe të burrave në Kosovë. Kjo revistë paraqiste profile të suksesshme të grave të Kosovës – studiuese, artiste, sportiste, punëtore uzinash etj. duke u përpjekur të projektonte modernizmin socialist jugosllav. Për disa vjet revista e kishte rubrikën e këshillave juridike për lexuesit. Në fund të faqeve, jepte edhe këshilla për gatim dhe dekorim të shtëpisë. Në vitet ’90-të, “Kosovarja” e ndryshon përmbajtjen. Temat që e përbënin këtë revistë si shumicën e revistave në atë periudhë, ishin ngjarjet e rënda politike dhe shtypja nga regjimi. Nga mesi i viteve të 1990-a, Kosovarja me pronarë privat orientohet nga bota e show-biz, por duke u përpjekur që të t’i ketë në fokus përsëri gratë e sukseshme në Kosovë.

Revistat në Kosovë

“Përparimi” ka qenë revistë që kishte për qëllim botimin e punimeve shkencore. Revista të tjera ishin: “Fjala”, “Pionieri”, “GEP”, “Shkëndija”, “Thumbi”.

Akordet e Kosovës

Ky Festival i këngës së lehtë (argëtuese) ka filluar në vitet 1969-1970 në Kino Rinia

Rinia këndon

Ky festival i këngës argëtuese (rock) ka filuar në vitin 1974.

BOOM

Ky festival ka filluar në vitin 1982. Janë mbajtur 3 deri 4 edicione të festivalit Boom.

Skena muzikore e Prishtinës

Ky festival është organizuar nga kompozitori Zeqirja Ballata gjatë viteve të '80-ta.

Financimi i kulturës:

BVI-ja për arsim e kulturë e Komunës së Prishtinës ka qenë përgjegjëse për financimin e shoqërive kulturore e artistike të komunës së Prishtinës. Bendet e qytetit kanë incizuar falas fillimisht në studion e Radio Televizionit të Prishtinës (RTP) në Veternik e më pas në studion e Radio Prishtinës. Distribuiimi dhe shitja e kasetave është bërë nga produksioni i RTP-së.

Pallati i Rinisë dhe Sporteve

Në kontekstin urban qendra sportive

rekreative, tani Pallati i Rinisë dhe Sporteve me madhësinë dhe numrin e aktiviteteve publike që zhvillohen në të paraqet një hapësirë komplekse publike të mbyllur dhe të hapur, vibrante gjatë tërë ditës për qytetin përmes tregtisë në zonën e përdhësës. Me 1974 ishte hapur konkursi për Qendrën Sportive Rekreative “Boro e Ramizi” në Prishtinë. Gjashtë zyra ishin ftuar. Dy prej tyre ishin tërhequr nga konkursi. Në nëntor të vitit 1974, juria kishte marrë vendim t’i jepte çmimin e parë propozimit të Entit për Studim dhe Projektim nga Sarajeva “DOM”, me ekipin e udhëhequr nga Zhivorad Janković, Halid Muhasilović dhe Espek Sretko. Ekipi ishte ftuar të zhvillonte edhe projektet zbatuese. Në vendimin e jurisë, shkruante si në vijim: Juria e përbërë prej 11 anëtarëve, në mënyrë unanime vendosi që shpërblimi i parë t’i jepet Entit për hulumtime dhe projektim “DOM” nga Sarajeva dhe i njëjti të shpërblehet me 80.000 dinarë. Në Prishtinë më 04.11.1974.

Koncepti themelor urbanistik i qendrës sportive rekreative, sipas autorëve, ka qenë krijimi i një tërësie hapësinore funksionale duke përfshirë Sheshin e Republikës, tani Sheshi “Zahir Pajaziti”, sheshin para Sallës Universale, Sallës së Vogël, Shtëpisë së Rinisë dhe pishinës së mbyllur. Projekti është kompozuar në mënyrë harmonike me të gjitha ndërtesat e Sheshit të Republikës. Në relacion me rrugën, Shtëpia e Rinisë është vendosur në plan të parë. Pishina e mbyllur, e cila nuk është ndërtuar asnjëherë, zinte vend në pjesën më të qetë të lokacionit, por në qendër

të zonës së terreneve të jashtme sportive. Me projekt është paraparë lidhja e ngrohtë në mes të pishinës së mbyllur dhe sallës së Sporteve. Rrjeti i brendshëm i trafikut në kompleks mundëson qasje të lehtë të automjeteve për të gjitha ndërtesat dhe lëvizjen e qetë të këmbësorëve brenda kompleksit. Përqendrimi i të gjitha hapësirave shërbyese në një trakt në mes të sallës universale dhe sallës së vogël ka mundësuar lëvizjen e ndarë në mes të publikut dhe sportistëve. Denivelimi i hyrjeve në palestrat e sportit dhe publikut ka mundësuar projektimin e foajeve të gjera të cilat mund të shfrytëzohen për ekspozita të ndryshme. Hapësirat e qendrës tregtare, garazhat, depot nën platonë hyrëse e rrisin vlerën e shfrytëzimit të ndërtesës e me këtë, përmbajtja e Sheshit të dikurshëm të Republikës lidhet me Qendrën sportive.

Teatri Dodona

Teatri "Dodona" u themelua më 12 nëntor 1986 si teatër i të rinjve, i fëmijëve dhe i kukullave "me vendim të Bashkësisë Punuese të Kuvendit Komunal të Prishtinës". Për themelimin e tij kontribuan Rabije Bajrami, Musa Ramadani, Ismajl Ymeri, Melihate Qea, Nuredin Loxha, Sherafedin Hoxha, Anton Çetta, Fadil Hysaj, Fahri Beqiri e të tjerë. 'Dodona' filloi me punë në maj të vitit 1987 me premierën e shfaqjes "Pylli është i të gjithëve" të autorit Shapi Grabovci, në regji të Borislav Mrkshiqit dhe asistent regjie Ismail Ymerin. Shfaqja u dha në Pallatin e Rinisë, duke u reprizuar plot njëqind herë dhe u pa

nga 141.077 fëmijë. Punën katër vjeçare me aktorë të regjisorit, të dramaturgut dhe të teatrologut nga Zagrebi, Borislav Mrkshiqit, e vazhdoi aktorja Melihate Qena. Puna e këtij teatri bëri një kthesë në artin skenik në Kosovë, duke inspiruar shikuesit e vegjël në aktorë profesionisë si të rritur.

Në vitin 1992, në rrugën 'Xhavit Mitrovica' e njohur si mahalla Çiklik, vendoset teatri në një ndërtesë, e cila kishte qenë hapsirë incizimi e mëpastaj klub boksi. Objekti renovohet dhe përshtatet për teatër. Shfaqjet e këtij teatri nisin punën në dy skena: të mëngjesit për fëmijë dhe atë të mbrëmjes për të rritur, ku kryesisht luanin studentët e aktrimit. Në vitin 1992, teatri emërtohet dhe njihet vetëm me emrin Teatri "Dodona". Shfaqja e parë që u dha në këtë teater në ndërtesën e re ishte shfaqja e 'Picrraku' (Karel Novak), me regji të Melihate Qenës, ndërsa në skenën e mbrëmjes premiera e parë ishte shfaqja 'Tregimi zoologjik' (Edward Elbee) në regji të Faruk Begolli. Shfaqja 'Profesor, jam talent se jo mahi', e dhënë edhe më herët në ish-teatrin popullor, vazhdoi të vihej në skenë në 'Dodonë'. Deri në instalimin e masave të dhunshme serbe, 'Dodona' udhëhiqej nga Enver Petrovci. Në rrethana të sistemit arsimor paralel, Teatri "Dodona" u shndërrua në një hapësirë alternative për Fakultetin e Arteve – Dega e Aktrimit, duke i kamufluar provimet e studentëve dhe shfaqjet e tjera nga drejtori i dhunshëm serb. Duke qenë që kjo nuk ishte gjithmonë e mundshme, shfaqjet shpesh edhe janë anuluar nga ky drejtor me

pretekstin se kanë përmbajtje nacionaliste. Shumica e shfaqjeve në “Dodonë” bëheshin me fare pak bugjet ose pa kurrfare bugjeti. Megjithatë, shfaqjet dhe loja e këtij teatri u shpërblye disa herë në festivale të teatrove në Shqipëri. “Dodona” përgjatë një dekade të sistemit paralel, ishte ndër alternativat e vetme të jetës kulturore në Kosovë. Pas luftës së 1999-ës, “Dodona” vazhdoi punën me shfaqje në dy skenat, nën udhëheqjen e Faruk Begollit. Përveç shfaqjeve, ‘Dodona’ ka mirëpritur edhe ekspozita të tjera arti: si fotografi, piktura etj.

Ulpiana arkeologjike

Ulpiana, ndryshe Municipium Ulpiana dhe Justiniana Secunda, ishte një qytet romak në rrethin e Graçanicës qysh nga fundi i shekullit II, që zhvillimin më të madh e ka arritur në periudhën në mes të shekujve III dhe IV. Gjatë kësaj periudhe kohore, qyteti e kishte epitelin Municipium Ulpiana Splendissima - Municipi i Ulpianës Madhështore apo të Shkëlqyer, duke u karakterizuar me rrjete të rrugëve të drejta, sistem ortogonal, ujësjellës, objekte të banimit si dhe me objekte publike, sakrale, profane e utilitare, posaçërisht gjatë sundimit të perandorit Justinian në shekullin VI, kohë kjo kur riemërohet në Justiniana Secunda.

Gjatë periudhës romake, gjeografikisht, Ulpiana ishte njëra nga qendrat kryesore gravituese komunikuese në mes të Konstantinopolit dhe Romës, për shkak të pozicionimi afër kryqëzimit të rrugëve që

e lidhnin Detin Adriatik me Detin Egje dhe jodrejtëpërdrejt edhe me Detin e Zi, gjithash-tu edhe falë pozicionimit afër kryqëzimit të rrugëve Via Lissus-Naissus dhe atë të Scupit.



Hotel Union.

Hotel Union

U ndërtua në vitin 1927 nën mbikqyrjen e arkitektit austriak Andija Kremer. Stili i ndërtësës ishte ndikuar nga arkitektura evropiane e kohës, duke përmbajtur elemente të neo-renesansës dhe të neo-barokut. Ndërtesa, e cila është e pozicionuar afër Pazarit të Vjetër të Prishtinës, frekuentohej zakonisht nga tregtarët vizitorë. Fillimisht ishte emëruar si “Hotel Skënderbeu”. Përbrenda ndërtësës gjendet një mur mozaiku i artistit Jakup Ferri, i punuar në vitin 2010.

Sistemi paralel

Sistemi paralel përfshinte shtrirje të një qeverisjeje paralele në Kosovë duke filluar nga arsimi, shëndetësia e deri te sporti. Kosova në këtë periudhë bojkotonte institucionet serbe, duke ndjekur vetëm ato të sistemit të ri të krijuar paralel, e cila qeverisjen e kishte në ekzil. Ajo filloi në vitet '90-të pas suprimimit të Kushtetutës dhe të Autonomisë së Kosovës, dhe nënkuptonte përveç tjerash edhe zhvendosjen e institucioneve nga objektet e shkollave publike në hapësirat e shtëpive private të qytetarëve. Përveç ekzekutivit dhe Kuvendit, shqiptarët u përjashtuan edhe të gjitha hapësirat publike: nga Radio Televizioni i Prishtinës, si institucion publik, nga stadiumet dhe objektet sportive, nga uni-

Prishtina
shkurt

versiteti, shkollat e mesme dhe shumë shkolla fillore, dhe nga të gjitha ndërmarrjet publike.

Së këndejmi, shqiptarët filluan të mblidhen nëpër shtëpi private duke mësuar me libra të bibliotekave personale, në kushte të vështira, pa tabela, karrige e tavolina. Ndër ndërtesat e vetme publike që u shfytëzuan vetëm për nga shqiptarët, ishte shkolla "Xhevdet Doda", e cila nuk u përdor nga serbët, për shkak që ishte më e vjetër dhe e dëmtuar. Kjo shkollë njihet për edukimin e disa brezave shumë të suksesshëm të nxënësve shqiptarë gjatë kohës së sistemit paralel të arsimit që pas luftës kanë ndihmuar shumë në shtet-formim.

Në kushte të sistemit paralel të organizimit, shqiptarët u detyruar të shpallin Republikën e Kosovës si shtet të pavarur, të njohur vetëm nga Shqipëria. Ky entitet politik e organizonte qeverisjen përmes qeverisë në ekzil, me një taksë 3% të mbledhur nga diaspora dhe gjithë qytetarët që gjenin disi punë. Livadhet dhe ambientet e improvizuara përdorehin për ligat paralele të sporteve, ndërkohë që kafeteritë e kishin rolin kryesor të ambi-



Ndërtesa e Qeverisë, dikur Banka e Kosovës.

enteve publike ku organizohet edhe jeta kulturore. Ekspozitat dhe shfaqjet rëndom organizoheshin nëpër kafiteri.

Ndërtesa e Qeverisë

Kjo ndërtesë ishte e njohur më parë si Banka e Kosovës dhe është e dizajnuar nga arkitektët Milan Tomic dhe Milan Pavlovic. U ndërtua në vitet 80, dhe në atë kohë ishte ndërtesa më e lartë në qytet. Plani fillestar ishte që dy ndërtesa identike të ndërtoheshin krahas njëra tjetres, por ky plan nuk u realizua kurrë. Ndërtesa është bombarduar gjatë luftës në Kosovë në vitin 99 dhe më vonu u renovua duke humbur elegancën dhe bukurinë e saj që kishte dikur.

Baret dhe kafeteritë

Pjesë shumë e madhe e mënyrës së jetesës në Prishtinë janë baret dhe kafeteritë. Rrugët të tëra janë të dedikuara dhe të stërmbushura me bare dhe kafeteri. Kafet e rakisë dhe Kafet e vogla janë ndër rrugët më të famshme dhe më të frekuentuara të Prishtinës. Si pije të preferuara në këto bare janë rakia tradicionale dhe birra. Përveç pijeve, në këto vende ofrohet edhe shërbimi i ushqimeve të ndryshme: të shpejt apo tradicional.

Shtatorja Bill Clinton

Në vitin 2009, është punuar statuja e ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton, nga skulptori Izeir Mustafa. Statuja u punua për ta nderuar presidentin për ndihmën dhe rolin e tij

gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë. Gjatësia e skulptures është rreth 3 metra dhe në dorën e majtë presidenti e mban mirënjohjen “Honoris Causa” që i është dhënë nga Universiteti i Prishtinës. Statuja është e vendosur në sheshin e emëruar sipas presidentit Bill Clinton.

Katedralja

Kulla e këmbanës së Katedralës “Nënë Tereza” është një ndër ndërtesat më të larta në Prishtinë. Pozicionimi dhe lartësia e saj ofrojnë një pamje mahnitëse të Prishtinës, nga të katër anët. Nga kjo pozitë, mund të shihen disa nga pjesët më interesante të qytetit, si kampusi i Universitetit të Prishtinës, pjesa perëndimore e qytetit nga ku përcillet perëndimi i diellit dhe në anët e tjera shihen ndërtesat e tjera të larta të qytetit. Që nga viti 2014, vizitorët mund të ngjiten në kullë dhe të shijojnë një pamje të rrallë të Prishtinës.

Qendra Historike

Qendra Historike e Prishtinës apo Zona Historike e Prishtinës përfshin një numër të madh objektesh të trashëgimisë kulturore dhe që gjenden në pjesën më të vjetër të qytetit të Prishtinës që dikur e kishte rolin e bërthamës së qytetit. Në këtë pjesë janë zhvilluar të gjitha aktivitetet e jetës shoqërore, administrative, ekonomike, zejtare, politike, kulturore dhe edukative. Çarshia e qytetit, hamami, hanet, dyqanet, xhamitë, shtëpitë individuale dhe sahatkulla ishin elementet që e përbënin bërthamën e Prishtinës së vjetër.

Sot kjo pjesë është e mbrojtur si Qendra apo Zona Historike e Prishtinës.

Muzeu i Pavarësisë

Objekti ka qenë fillimisht selia e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, ndërsa me 17 shkurt 2018 është shndërruar në Muzeun “Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova”. Ndërtesa njëherësh shërbente si zyrë e dr. Ibrahim Rugovës, ndërsa në vitin 2004 ai kishte propozuar që kjo shtëpi të shndërrohet në muze që do ta tregonte dhe simbolizonte rrugëtimin e pavarësisë së Kosovës.

Jeta e natës

Shumëllojshmëria e vendeve dhe e aktiviteteve në Prishtinë, vitet e fundit, e ka transformuar Prishtinën në qendrën kryesore për jetë të natës në Kosovë. Lokalet dhe klubet e natës fillojnë të frekuentohen nga orët e pasditës dhe shpesh qëndrojnë të hapura deri në orët e para të mëngjesit.

Prishtina njëherësh është bërë një nga qendrat më të forta për organizimin e ndejave të muzikës elektronike, rok dhe hip-hop. Gjithashtu, në Prishtinë organizohen festivale të muzikës dhe të filmit, të cilat kanë aktivitete që organizohen edhe gjatë mbrëmjes, qofshin ato shfaqje të filmave apo organizim i koncerteve.

Arkitektura moderniste

Arkitektura moderniste në Prishtinë filloi të merrte hov pas vitit 1945 dhe vazh-



doi deri në vitet '90-të. Ndërtesat e këtij stili të arkitekturës karakterizohen kryesisht me inxhinieri të ndërtimit industrial për ta mundësuar ndërtimin e objekteve më të mëdha dhe më të forta me materiale si beton, xham, hekur etj. Në Prishtinë, objektet që janë ndërtuar me këtë frymë dhe stil arkitektonik janë: Biblioteka Kombëtare, Pallati i Rinisë dhe i Sporteve (ish-Boro dhe Ramizi), Radio Kosova, Pallati i Shtypit Rilindja, Pallati i KEDS-it, Ndërtesa e PTK-së, ish-Hotel Union etj.. Gjithashtu, me stil të njejtë të arkitekturës janë planifikuar dhe ndërtuar edhe lagjet si: Dardania, Ulpiana, Bregu i Diellit etj.

Stacion & Klubi i Boksit

Është një nga hapësirat ekspozuese dhe galeritë e pakta të qytetit. Gjendet në pjesën e qytetit të vjetër, në njëren nga ndërtesat e mbrojtura me ligj. Hapësira, gjithashtu, e posedon edhe Muzeun e Artit Amerikan, që është një ekspozitë e vogël dedikuar artit amerikan. Stacioni ekspozon artistë lokal dhe ndërkombëtar.

Lambda Lambda Lambda

Është një galeri ndërkombëtare e artit bashkëkohor që gjendet në Prishtinë. hapësira i dhuron artistëve, profesionistëve, dhe audiencës me një ambient intim dhe joformal që është i përshtatshëm për eksperimentim, diskutime, dhe për të nxënë. LambdaLambdaLambda u themelua në vitin 2014 dhe ka për synim përforcimin e dialogut ndërmjet

artistëve lokal dhe ndërkombëtar.

Hapësira Motrat

Motrat është një galeri e artit bashkëkohor që u hap në mars të vitit 2017. Gjenet në katin e parë të studios së dizajnit dhe reklamave Trembelat. E themeluar si organizatë joqeveritare, Motrat synon mbështetjen e artistëve lokal me organizimin e ekspozitës së parë personale të tyre. Është e hapur nga ora 9:00 deri në 18:00 nga e hëna në të premtën.



Pylli i Arinjve në Badovs, 15 kilometra nga Prishtina.

Strehimorja e Arinjve

Sanctuary Bear Prishtina është një park kombëtar në Kosovë që gjendet në afërsi të qytetit të Prishtinës. Për shumë vite, nuk kishte ligj kundër mbajtjes së ariut të kaftë në Kosovë. Të gjithë arinj të mbajtur privatisht kanë jetuar në kafaze të vogla nëpër restorante. Ata kanë lindur kryesisht në pyjet e Kosovës ose të Shqipërisë dhe janë rrëmbyer prej nënave të tyre nga tregtarët e kafshëve. Si arinj të restoranteve ata duhej të tërhiqnin klientë dhe kështu përfitonin pronarët e tyre. Në nëntor të vitit 2010, kur u bë e paligjshme për të mbajtur arinjë privatisht, u shfaq nevoja për një park kombëtar si një shtëpi e re për arinj të shpëtuar nga robëria. Sanctuary Bear Pr-



ishtina u themelua në vitin 2013 nga Four Paws Austria në bashkëpunim me KFOR-in, Qytetin e Prishtinës, Ministrinë e Mjedisit të Kosovës, dhe firmën ligjore Franke & Partner. Sanctuary ofron strehim të përshtatshme për të gjithë arinjtë e restoranteve, me rrethime të mëdha që i përngjajnë habitatit natyror të arinjve.

Shtëpia e Gurit

Shtëpia e Gurit, e njohur edhe si “sinagoga” është ndërtesa e vetme që ka mbijetuar në Pazarin e Vjetër në Prishtinë. Ajo që dikur i takonte Komunës Hebraike të Prishtinës dhe shërbente si dyqan farkëtarësh, në një kohë u përdorte edhe si Sinagogë. Ndërte-

Rrethrotulimi i Madh në hyrje të qytetit, në lagjen Lakrishte.

sa që fillimisht kishte një çati prej guri, si një nga ndërtesat e vetme e ndërtuar me materiale të qëndrueshme, në vitet '60-të u çmontua fizikisht dhe u zhvendos nga Pazari i vjetër në kompleksin Emin Gjiku. Aktualisht arkitekti i njohur botëror Ron Arad po punon për një projekt që do ta kthejë ndërtesën në trashëgimi hebraike të Kosovës dhe në qendër ndërfetare.

Domaniku House

E ndërtuar në shekullin XIX të, shtëpia Domaniku shërbeu si një nga shumë hanet në qendrën e vjetër të Prishtinës. Shtëpia, e ndikuar nga arkitektura urbane osmane, për shkak të degradimit të saj duhej të rindërtohet tërësisht gjatë mesit të viteve '60-të. Megjithatë, gjatë rikonstruksionit u ndryshuan pjesë të rëndësishme të ndërtesës: hyrja dhe vendi i shkallëve, në disa pjesë të ndërtesës materiali u ndryshua nga druri dhe suva në beton; tipologjia dhe elementët e përgjithshëm arkitektonikë mbetën të njëjta.

Kisha e Shën Kollit

Është e Kisha e vetme Ortodokse e mbetur në Prishtinë. Kisha u ndërtua në shekullin 19 nga gurpunuesit e Dibrës, qytet në perëndim të Maqedonisë që është i famshëm për zejtarët dhe arkitektët e saj. Kisha ishte e famshme për ikonostasat e saj që u shkatërruan gjatë trazirave të vitit 2004. Në fund të shekullit 19, u hap shkolla e parë serbe në Prishtinë, mu në mjediset e Kishës.

Përmendorja e Lirisë

U dizajnuar nga skulptori serb Miodrag Zirkovic në vitin 1957 dhe u ndërtua në vitin 1959. Përmendorja Vllaznim-Bashkim u ndërtua gjatë një kohe kur po ndodhnin ndryshime të mëdha në kryeqytetin e Kosovës. Autoritetet Jugosllave sollën një frymë të re të realizmit socialist i cili u manifestua edhe nëpërmjet arkitekturës. Sipas autorit, përmendorja simbolizon bashkimin e etnive të ndryshme që jetonin atëkohë në Prishtinë.

Ndërtesa e Radio Kosovës

Ndërtesa e Radio Kosovës është një nga shembujt më përfaqësues të arkitekturës brutaliste të Prishtinës. Ndërtesa u projektua në vitin 1982 dhe u ndërtua disa vite më vonë. Dizajnimi i saj u bë nga studioja shtetërore "Slovenia Projekt" nga Ljubljana, që për kryesues të ekipit punues kishte arkitektin Franc Rihter.

Kuvendi i Kosovës

E vendosur mbi Pazarin e vjetër të Prishtinës, u projektua fillimisht nga Bogdan Nestoroviç më 1948 dhe më vonë u adaptua dhe riprojektua nga arkitekti i njohur kroat Juraj Neidhardt në vitin 1960. Neidhardt i lindur në Zagreb, por pas shumicës së jetës së tij në Sarajevë, përfundoi shkollën e arkitekturës në Vjenë dhe punoi në zyrën e Le Corbusier në Paris gjatë viteve 1932 dhe 1936. Gjatë viteve të fundit, ndërtesa u modifikua shumë sidomos në sallën e mbledhjeve të parlamentit, fasadën lindore dhe atë jugore.

Elektrokosova

U dizajnuar në vitin 1977 nga arkitekti Dragan Kovacevic nga studioja shtetërore "Invest Biro" që ka dizajnuar një numër të konsiderueshëm të projekteve në Prishtinë. Të impresionar nga pamja e saj, banorët filluan ta quajnë ndërtesën "Lepa Brena", që ishte një këngëtare e famshme e asaj kohe.

Kompleksi i Kurrizit

Kurrizi, është kompleksi më i madh i banimit dhe mallrave të këtij llojit të vet Kosovë. Projekti ishte shumë i ndikuar nga teoritë arkitekturore dhe urbane të viteve '70 dhe '80 që e ndan kompleksin në tre nivele. Niveli i tokës ka një rrugë tregtare të mbyllur dhe paralel me atë të një tuneli ku automjetet janë të ndara fizikisht nga këmbësorët, niveli i dytë ka një bulevard të gjerë që shtrihet për gati 400 metra dhe gjithashtu ka dyqane të rradhitura në njërën anë dhe nivelin e banimit që ngrihet mbi bulevard. Ekzistonte një mit urban në Prishtinë që kompleksi duhej të zgjaste deri në lagjen Bregu i Diellit, por për shkak të trazirave të vitit 1981 plani u anuluan. Kurrizi u projektua nga studioja shtetërore Plani i Zagrebit dhe ekipi i projektimit u drejtua nga Drazhen Jankoviç dhe Darko Kozjak.

Monumenti Newborn

Është skulptura tipografike që ka shënuar ditën e Pavarësisë së Kosovës 17 shkurtin 2008, ditë edhe në të cilën është vendosur

para Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Monumenti u punua pa ndalë për 10 ditë me rend në mënyrë që të përfundohet për datë të parvarësisë. Fillimisht ngjyra e shkronjave ishte e verdhë, mirëpo tradicionalisht ngjyrat e shkronjave ndryshojnë çdo 17 shkurt. Dimensionet e monumentit janë 3 metra lartësi, 24 metra gjatësi, dhe 0.9 metra trashësi, kurse pesha e saj është rreth 9 ton.

Teatri Kombëtar i Kosovës

Teatri Kombëtar i Kosovës u themelua me Vendim të Kuvendit të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës në tetor të vitit 1946 në Prizren dhe në fillim kishte emrin Teatri Popullor Rajonal e pastaj Teatri Popullor Krahinor. Ky ishte institucioni i parë teatror profesionist në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Disa muaj pas themelimit, Teatri Popullor Krahinor u transferua në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Deri në vitin 1989 ky teatër i ka realizuar mbi 400 premiera me rreth 10.000 repriza, të cilat janë përcjellë nga mbi 3.300.000 spektatorë. Në vitin 1999, pas mbarimit të luftës në Kosovë, ky teatër pagëzohet me emrin Teatri Kombëtar i Kosovës dhe vazhdon aktivitetet e saj me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë, dhe Sportit.

Banka Qëndrore e Kosovës

Banka Qendrore e Kosovës ndodhet në një ndërtesë tipike institucionale në rrugën Garibaldi në Prishtinë. Prapa hotel Grandit. Kjo ndërtesë karakteristike moderniste

është ndërtuar në vitet e 80-ta. Në vitin 2016 është bërë kërkesë për të shtuar edhe një kat në këtë ndërtesë, por ajo është refuzuar nga zyrtarë komunal.

Teatri ODA

Teatri i Pavarur ODA në Prishtinë, Kosovë, u themelua në fund të vitit 2002. Në fillim Teatrin ODA nuk kishte një hapësirë të përhershme për aktivitetet e saj, por me projektin e saj të parë që u shfaq në një hapësirë të huazuar, më vonë u transformua dhe u bë hapësira që ka shërbyer si një rezidencë e të këtij teatri për një dekadë. Fillimisht ndërtesa e teatrit ka qenë një klub bowling, më pas u shndërrua në një diskotekë, dhe pastaj në një teatër me përdorim fleksibil për shfaqje të ndryshme, i përshtatshëm për një gamë ngjarjesh nga më të voglat e më intime deri te ato për evente të mëdha.





